



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2020

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit për 8-mujorin e vitit 2020 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3

TIRANË

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit administron dhe menaxhon fondet buxhetore për programin:

➤ **Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- **Zbatimi i Ligjit nr. ligjit 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore” në disa drejtime:**
- ✓ Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.
- ✓ Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur dhe autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.
- ✓ Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga ligji 45/2015, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991.
- ✓ Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale
- ✓ Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

Autoriteti në përmbushje të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, për çdo kërkesë të paraqitur nga:

1. Institucionet për:

- ✓ verifikimin e zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë;
- ✓ verifikimin e kandidatëve për funksione të zgjedhshme;
- ✓ verifikimin e propozimeve për dhënie dekoratash, tituj nderi, medalje dhe titujt vendorë të nderit.

2. Individët për:

- ✓ njohje në cilësinë e; - të prekurit; - palës së tretë; - bashkëpunëtoreve; - të favorizuarëve të Ish-Sigurimit të Shtetit.
- ✓ rehabilitimin e të prekurve, të të vdekurve apo të të zhdukurve;
- ✓ dëmshtëpërblimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ ruajtjen e të drejtave të personalitetit dhe shmangies së dëmit moral;
- ✓ qartësimin e fatit të të humburve, të të zhdukurve dhe të rasteve të pasqaruara të vdekjeve

3. Studiuesit dhe Media për qëllime:

- ✓ kërkimore;
- ✓ historike;
- ✓ edukimi.

ndjek procedurat si më poshtë:

Për çdo kërkesë të paraqitur nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Media, Autoriteti:

- ✚ Parakishit shqyrton dhe trajton në mbledhje të Autoritetit, legjitimitetin e kërkesës së paraqitur, duke vendosur ndjekjen e procedurave në vijim dhe shqyrtimin e dokumentacionit përkatës.
- ✚ Dërgon shkresat për vazhdimin e procedurës institucioneve përkatëse, për kontrollin dhe verifikimin e figurës së personave, sipas të dhënave të identitetit të tyre dhe në rast mungesë të dhënash, bën me dije shkresërit institucionin, individin, studiuesin dhe median e interesuar që ka paraqitur kërkesën, për plotësimin e të dhënave plotësuese sa më shpejt, me qëllim administrimin e dokumentacionit përkatës dhe vijimin e shqyrtimit të tij nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e verifikimit të figurës së shtetasit mbi bazën e objektit të kërkesës, si dhe mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.
- ✚ Kryen procesin e deklasifikimit të dosjeve dhe bën bibliografinë e secilës (dosje formulare, dosje përpunimi, dokumente, fashikuj etj), në rastin kur dokumentacioni i administruar është i klasifikuar.
- ✚ Kryen përpunimin e dokumentacionit, para se ai t'i vihet në dispozicion kërkuesit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin 45/2015.
- ✚ Kryen trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi në mbledhje të Autoritetit, mbi bazën e rezultatit të verifikimit të dokumentacionit të administruar nga Autoriteti.

Treguesit për matjen e performancës janë:

- Numri në rritje të kërkesave nga Institucionet, Individët, Studiuesit dhe Mediat të trajtuara nga ana e Autoritetit;
- Numrin e ankesave në raport me vendimet e marra nga ana e Autoritetit;
- Koha e trajtimit të një kërkesë

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ju dërgojmë raportin e monitorimit të buxhetit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për 8-mujorin e vitit 2020, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektivave.

Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet në %, çdo kategori shpenzimesh, përkundëjt totalit të buxhetit, si dhe realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundëjt buxhetit të akorduar.

Në mijë lekë

Nr	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2020	Buxheti me ndryshimet Viti 2020	Realizimi faktik 8-mujore 2020	
				Në vlerë	Në %
1	Planifikim-Menaxhim-Administrim	83 000	78 000	37 926	48.6%

Përbërja e shpenzimeve buxhetore, sipas klasifikimit ekonomik të shpenzimeve, sipas buxhetit dhe realizimit faktik të vitit 2020, jepet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Llog	Emertimi	Buxheti Fillestar Viti 2020	Buxheti me ndryshimet Viti 2020	Realizimi faktik Viti 2020	
				Në vlerë	Në %
600	Fondi i Pagave	59 500	51 300	27 966	54.5%
601	Kontrib. Sig. Shoq & Shënd.	4 500	9 700	4 418	45.5%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	18 000	16 000	4 770	29.8%
231	Kapitale të Trupëzuara	1 000	1 000	772	77.2%
	T o t a l i	83 000	78 000	37 926	48.6%

Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore, është realizuar respektivisht në vlerën **27 966 (në mijë) lekë** për paga si dhe **4 418 (në mijë) lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, ose 53 % të planit vjetor të këtij shpenzimi (600-601).

Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e pezullimit të rekrutimeve të personelit, situatë e krijuar nga përhapja e virusit covid-19. Ndërkohë po vijohet me plotësimin e vendeve vakante sipas planit të rekrutimeve të miratuar në mbledhjen e Autoritetit.

Është punuar për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Autoritetit (për periudhën janar-gusht), nëpërmjet trajnimeve të ASPA

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602 -606), për periudhën 8 –muajore 2020, është realizuar respektivisht në vlerën **4 770 (në mijë) lekë** ose 29.8 % të planit vjetor të këtij shpenzimi (602-606).

Fondi është realizuar për:

- Shpenzime për kancelari 316 644 lekë
- Materiale për pastrim, dezinfektim, në vlerën 59 988 lekë.
- Uniforma dhe veshje speciale për arkivën në vlerën 511 200 lekë.
- Shpenzime për energji elektrike dhe ujë respektivisht 1 210 181 lekë dhe 88 860 lekë
- Janë likujduar faturat për shërbimin e internetit sipas kontratës në vlerën 71 600 lekë.
- Shpenzime postare sipas kontratës së lidhur me postën shqiptare në vlerën 58 480 lekë.
- Shpenzime transporti për taksa, transport nga të tretët dhe siguracion të automjeteve në vlerën 44 800 mijë lekë..
- Shpenzime në funksion të realizimit të aktiviteteve të Autoritetit për printime banera në vlerën 44 800 lekë.
- Për udhëtime fondi total i shpenzuar është 1 857 077mijë lekë, nga te cilat:
 - 1.Dieta në vlerën 325 117 lekë
 - 2.Bileta në vlerën 303 756 lekë.
- Mirëmbajtje pajisje kompjuterike në vlerën 24 285 lekë.
- Shpenzime për honorare ku perfshihen pagëesat e pedagogëve që marrin pjesë ne komisionet e rekrutimit të punonjësve të rinju në vlerën 152 500 lekë.
- Shpenzime përkthimi në vlerën 112 794 lekë.
- Shërbime të printimit dhe publikimit në vlerën 34 200 lekë.
- Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca në vlerën 223 960 lekë.

Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e pezullimit tërësisht i të gjithë aktiviteteve brenda e jashtë shtetit (të planifikuara), nga situata e pazakontë e krijuar nga përhapja e covid-19, për shkak të së cilës nuk janë ndërmarrë procedura prokurimi dhe jo vetem. Për shkak të situatës së pazakontë të krijuar nga përhapja e virusit, janë rishikuar shpenzimet e planifikuara për t'u kryer, duke i orientuar drejt prioriteteve, për sigurimin dhe garantimin e mbrojtjes së shëndetit të stafit, por edhe në të tjera shpenzime sipas situatës dhe kufizimeve të shpallura.

Me rikthimin gradual të paraqitjes së plotë të strukturave përgjegjëse të prokurimit, duke respektuar masat e marra nga organet kompetente, do të vijohet me kryerjen e finalizimin e

procedurave për sigurimin e materialeve e pajisjeve, sipas prioriteteve si dhe duke garantuar vazhdimësinë e veprimtarisë së përditshme.

Fondi për shpenzime investime (zëri 231), ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve është 1.000 (në mijë) lekë. Realizuar në vlerën 772 080 lekë, ku fondi prej 744 480 lekë janë blerë pajisje kompjuterike dhe 27 600 lekë janë shpenzuar për kolaudimin e punimeve të godinës.

Financimi i huaj nga Ambasada Suedeze për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK, për krijimin e një arkive moderne” është në shumën 8 000 (mijë) lekë, realizimi për periudhën 8-mujore është sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lekë

Artikulli	Totali i artikullit
600-----Paga	739.00
601-----Sigurime shoqerore	205.00
602-----Shpenzime operative	3.00
TOTALI	947.00

Të ardhurat nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave

Për periudhën e raportuar, Autoriteti arkëtoi të ardhura nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave për riprodhimin e informacionit dhe dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në vlerën 115 410 lekë. Të ardhurat derdhen në masën 100% në buxhetin e shtetit.

Krahasimi i të dhënave faktike ndërmjet Autoritetit dhe Thesarit

Në mijë lekë

Nr	Emertimi i programit	Shpenzimet korente		Shpenzimet kapitale		Totali		Diferenca
		Autoriteti	Thesari	Autoriteti	Thesari	Autoriteti	Thesari	
1	Planifikim - menaxhim - administrim	77 000	77 000	1 000	1 000	37 926	37 926	0

Në Aneksin nr. 3 është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) nga kryerja e aktiviteteve, në zbatim të objektivave për vitin 2020.

Gjatë periudhës objekt raportimi **1 Janar - 31 Gusht 2020**, Autoriteti ka marrë pjesë në **22** mbledhje të Autoritetit, ku ka paraqitur për legjitimim **162** kërkesa të reja nga të cilat **3** zbardhje bashkëpunëtorësh, dhe për mbyllje procedure **298** kërkesa, nga te cilat:

- i) Me dokumentacion arkivor janë 184 kërkesa dhe 3 zbardhje bashkëpunëtorësh,
- ii) Pa dokumentacion arkivor janë 111 kërkesa,

Ndër to :

- i) 10 kërkesa të 2018
- iii) 236 kërkesa të 2019
- iv) 52 kërkesa të 2020

Në total:

- i) Përpunuar mbi **65 000** faqe dokumentacion arkivor.
- ii) Anonimizuar mbi **30 000** faqe dokumentacion arkivor.

Nga 170 kërkesa të paraqitura që nga fillimi i viti 2020 deri në fund të periudhës janar – gusht 2020 që po marrim në shqyrtim janë futur për legjitimim 168 kërkesa dhe vetëm 2 janë në pritje për plotësim dokumentacioni.

- janë paraqitur për legjitimim **59** kërkesa të reja, për **125** kandidatë,
- janë marrë **87** vendime,
- **8** kandidatë (individ) kanë rezultuar me probleme.

- Gjatë periudhës janar – gusht 2020, numri i kërkesave për informim për qëllime të kërkimit shkencor apo medias, të cilat janë paraqitur me materiale për trajtim është 65 dhe numri i mbledhjeve në të cilat është marrë pjesë është 19.
- Janë dërguar rreth 62 shkresa Drejtorisë së Arkivit; janë reflektuar në tabelën e të dhënave statistikore të Drejtorisë së Mbështetjes
- Janë marrë rreth 47 vendime për vënie në dispozicion të dokumenteve të gjetura nga DA, dhe janë hartuar e firmosur nga kërkuesit në prani të një punonjësi të Sekretariatit Teknik, po aq deklarata konfidencialiteti.

Është punuar për përmirësimin dhe përditësimin e databazës të informacionit mbi kërkesë/ankesat si dhe korrespondenca me DA-në dhe sektorët e tjerë në funksion të aplikimeve

Në ushtrim të detyrës është punuar me prioritet në kuadër të procesit të mbrojtjes së të dhënave gjatë dhënies së informacionit, në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar si dhe zbatimi në përputhje me ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar) dhe ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën për Informim”, krahas garantimit të integritetit të procesit në përgjithësi dhe dhënien e informacionit, duke e bërë informacionin lehtësisht të aksesueshëm, të saktë dhe të plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.

Realizimi i buxhetit për periudhën 8-mujore u monitorua me përgjegjesi dhe u kërkua angazhimi i të gjitha strukturave të AIDSSH-së me qëllim realizimin me sa më efikasitet dhe efektivitet i fondeve të planifikuara për vitin 2020. Problemat e konstatuara gjatë këtij 8 mujori do jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit për katërmujorin pasardhës.

Materiali është i publikuar në faqjen zyrtare të AIDSSH-së : www.autoritidosjeve.gov.al

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Skënder Vrioni